



# Rezultate: Anketa për numrin 25 të revistës nga Business Magazine Albania




## 1. A e ndiqni Business Magazine Albania online?

75.2% e të anketuarve u përgjigjën se e ndjekin Business Mag online në mediat sociale dhe në faqen e webit. Kur publikojmë numrin e ri të revistës, kujdesemi që ta publikojmë në dy formate, në atë digjital dhe atë print.



## 2. A i merrni numrat e revistës në format digjital sa herë që publikohet?

Nga të anketuarit, 44.4% u përgjigjën që e kanë marrë formatin digjital të revistës, i cili ka qenë gjithmonë falas, ndërsa 55.6% është përgjigjur se nuk e kanë marrë.




## 3. A do dëshironit të kishit variantin e printuar të revistës?

52.9% janë përgjigjur se dëshirojnë të kenë në duar variantin e printuar të revistës dhe 26.1% janë në mëdyshje për këtë variant të revistës.




## 4. Do të ishit të gatshëm të paguanit një abonim për të marrë?

"Jam i gatshëm të paguaj një abonim vjetor për të marrë vetëm versionin digjital" u përgjigjën 32% e të anketuarve, 22.2% u shprehën se do të paguanin vetëm për versionin print dhe 24.2% janë shprehur se pas pagesës do donin të kishin të dy versionet.




## 5. Cili do të ishte çmimi që do të ishit të gatshëm të paguanit për versionin digjital?

58.8% janë shprehur se janë të gatshëm të paguanjë më pak se 10\$ në vit për versionin digjital, ndërsa 26.1%, 15-20\$ në vit.




## 6. Cili do të ishte çmimi që do të ishit të gatshëm të paguanit për versionin print?

38.6% e të anketuarve u shprehën se do ishin të gatshëm të paguanin 15-20\$ në vit për versionin print të revistës, 37.8% u shprehën se do paguanin më pak se 15\$ në vit, ndërsa 9.8% do paguanin 25-30\$ në vit.




## 7. Cili do të ishte çmimi që do të ishit të gatshëm të paguanit për versionin print & digjital së bashku?

28.8% e të anketuarve u shprehën se do ishin të gatshëm të paguanin më pak se 15\$ në vit, 36.6% u shprehën se do të paguanin 15-20\$ në vit, ndërsa 21.6% do të paguanin 25-30\$ në vit.



## 8. A do ishit të gatshëm të paguanit online?

75.8% e të anketuarve janë përgjigjur se janë të gatshëm të paguanjë online, për të marrë versionin digjital dhe atë print.



## 9. Cila do të ishte mënyra e përshtatshme për të paguar?

Përballë opsioneve 48.4% u përgjigjën se e kanë më të thjeshtë pagesën nëpërmjet kartës së kreditit/debitit, 15% me Paypal, 20.9% me pagesë CASH në dorëzim dhe 2.5% me EasyPay.